



KOMISIONI
EVROPIAN

Bruksel, 9.11.2016
COM(2016) 715 final

**KOMUNIKATA NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN EVROPIAN, KËSHILLIN,
KOMITETIN EKONOMIK DHE SOCIAL EVROPIAN DHE KOMITETIN E RAJONEVE**

Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2016

{ SWD(2016) 360 final}
{ SWD(2016) 361 final}
{ SWD(2016) 362 final}
{ SWD(2016) 363 final}
{ SWD(2016) 364 final}
{ SWD(2016) 365 final}
{ SWD(2016) 366 final}

I. HYRJE

Në nëntor të vitit 2015, Komisioni Evropian ka përcaktuar një strategji afatmesme për politikën e zgjerimit të BE-së për të mbuluar periudhën e mandatit të këtij Komisioni. Ajo u miratua nga Këshilli në dhjetor 2015. Kjo komunikatë mbikqyr zbatimin e kësaj strategjie, nxjerr përfundime dhe rekomandime përsa i përket vendeve të veçanta të zgjerimit dhe çështjeve të caktuara tematike.

BE-ja vazhdon të përballet me sfida serioze në fronte të ndryshme. Krizat e shumëfishta kanë potencial destabilizues jo vetëm për Evropën por për të gjithë botën. Tërheqja e BE-së në vendet e zgjerimit ka qenë pjesërisht e prekur nga rënia ekonomike dhe skepticizmi në lidhje me projektin evropian.

Në të njëjtën kohë, perspektiva për anëtarësim në BE, siç është rikonfirmuar nga të gjitha shtetet anëtare, vazhdon të udhëheqë transformimin dhe të vendosë stabilitet dhe siguri në vendet e Evropës Juglindore. Për këtë arsye, një proces i besueshëm i zgjerimit, bazuar në kushtëzim të rreptë dhe të drejtë, mbetet një mjet i pazëvendësueshëm për forcimin e këtyre vendeve si dhe për të ndihmuar në mbështetjen e modernizimit të tyre përmes reformave politike dhe ekonomike, në përputhje me kriteret e pranimit.

Politika e zgjerimit vazhdon të japë rezultate dhe reformat janë duke ecur përpara në shumicën e vendeve, ndonëse me shpejtësi të ndryshme. Duke pasur parasysh natyrën komplekse të reformave të nevojshme, ky është një proces afatgjatë dhe të metat strukturore vazhdojnë të ekzistojnë, veçanërisht në fushat kryesore të sundimit të ligjit dhe ekonomisë.

Në Turqi në mënyrë më specifike, Samiti BE-Turqi i 29 nëntorit 2015 dhe deklarata pasuese në mes të BE-së dhe Turqisë më 18 mars 2016 çuan në uljen e dukshme të migrimit të parregullt dhe në rivitalizimin e marrëdhënieve BE-Turqi. Më 15 korrik, institucionet demokratike dhe shoqëria si tërësi u tundën nga përpjekja për grusht shtet në Turqi, të cilën BE-ja e dënoi ashpër.

Angazhimi i vazhdueshëm i principit të “të drejtave themelore” mbetet thelbësor për vendet e zgjerimit. Komisioni do të vazhdojë të përqëndrojë përpjekjet mbi sundimin e ligjit, duke përfshirë sigurinë, të drejtat themelore, institucionet demokratike dhe reformën e administratës publike, si dhe në zhvillimin ekonomik dhe konkurrencën. Këto mbeten bazat për përmbushjen e kriterëve për anëtarësim të Kopenhagës dhe të Madridit. Roli më i fortë i shoqërisë civile dhe i grupeve të interesit mbetet vendimtar.

Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme që të kuptojmë se negociatat e anëtarësimit nuk janë - dhe kurrë nuk kanë qenë - një qëllim në vetvete. Ato janë pjesë e një procesi më të gjerë të modernizimit dhe reformave. Qeveritë e vendeve të zgjerimit duhet të përqafojnë reformat e nevojshme në mënyrë më aktive dhe ta bëjnë këtë agjendë të tyre politike - jo sepse BE-ja kërkon këtë por për shkak se ajo është në interesin e qytetarëve të tyre. Mbështetja publike për zgjerimet e ardhshme do të varet nga shkalla e përgatitjes së vendeve kandidate. Prandaj, reformat përmes procesit të pranimit në BE ndihmojnë në rritjen e besimit të qytetarëve të Shteteve Anëtare të BE-së dhe të vendeve kandidate.

II. ZBATIMI I STRATEGJISË PËR ZHVILLIM E VITIT 2015

a) Sundimi i ligjit

Në përgjithësi, ka pasur përpjekje për të modernizuar kornizat ligjore dhe infrastrukturën, si dhe për të siguruar trajnim më të mirë për gjyqtarët dhe prokurorët. Në korrik, Parlamenti i Shqipërisë miratoi unanimisht ndryshimet kushtetuese të cilat janë bazë për një reformë të thellë të sistemit gjyqësor. Serbia miratoi plane gjithëpërfshirëse të veprimit për sundimin e ligjit, të cilat vendosin programin e punës për reformat në kapitujt 23 dhe 24.

Megjithatë, progresi në ngritjen e **sistemeve gjyqësore** të pavarura dhe funksionale dhe mbetet i ngadalshëm, ku shumica e vendeve vazhdojnë të përballen me problem të efikasitetit dhe mungesës të pavarësisë dhe llogaridhënies të mjaftueshme. Në Turqi, pavarësia e gjyqësorit është dobësuar me ndryshimet e mëdha të bëra në strukturat dhe përbërjen e gjykatave të larta, siç është presioni i vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët. Shkarkimi i një të pestës së gjyqtarëve dhe prokurorëve pas përpjekjes për grusht shtet të 15 korrikut, paraqet një sfidë të mëtejshme të rëndësishme për funksionimin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, të metat serioze të cilat janë vënë në dukje me rastin e përgjimeve të publikuara ende nuk janë adresuar në mënyrë adekuate.

Në vitet e fundit, të gjitha vendet kanë forcuar kornizat e tyre për trajtimin e **korruptionit dhe krimit të organizuar**. Institucionet e reja - të tilla si Agjencia Kundër Korruptionit e Malit të Zi - janë themeluar dhe përpjekjet e konsiderueshme janë duke u bërë për të nxitur specializim, si në polici ashtu edhe në gjyqësi. Përkundër këtyre përpjekjeve, disa vende në rajon vazhdojnë të tregojnë simptome të qarta dhe shkallë të ndryshme të kapjes së shtetit. Kompanitë, institucionet apo individë të fuqishëm përdorin praktika të paligjshme për të ndikuar në politika, në mjedisin ligjor dhe ekonominë e interesave të tyre. Angazhimi i deklaruar politik për të luftuar korruptionin nuk është kthyer sa duhet në rezultate konkrete. Prandaj, përpjekjet duhet të fokusohen më shumë se kurrë në krijimin e të dhënave të gjurmimeve bindëse dhe të qëndrueshme në këto fusha në bazë të hetimeve efikase, efektive dhe të paanshme, ndjekjeve penale dhe vendimeve të gjykatave në rastet e të gjitha niveleve. Nevojitet më shumë transparencë në prokurimin publik. Rezultatet në luftën kundër krimit të organizuar duhet të shkojnë përtej rasteve individuale. Autoritetet duhet të fillojnë në mënyrë serioze shkatërrimin e rrjeteve kriminale dhe konfiskimin e asetëve, duke përfshirë edhe përdorimin e mjeteve më ambicioze dhe të fuqishme si konfiskimin e zgjeruar të pasurisë dhe përdorimin sistematik të hetimeve financiare. Përpjekjet duhet të rriten për të trajtuar trafikimin e armëve të zjarrit. Progresi i bërë gjatë viteve të fundit në trajtimin e trafikimit të qenieve njerëzore dallon. Më shumë përpjekje janë të nevojshme për përafrimin me *acquis* përkatëse dhe për të siguruar zbatimin efektiv të masave parandaluese, si dhe mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat.

Terrorizmi dhe radikalizimi vazhdojnë të përbëjnë një kërcënim të sigurisë për BE-ne dhe vendet e zgjerimit. Turqia është prekur veçanërisht nga disa sulme vdekjeprurëse terroriste në shkallë të madhe gjatë vitit të kaluar. Fenomeni i luftëtarëve nga BE dhe vendet e zgjerimit, të cilët udhëtojnë për t'u bashkuar me grupet kryengritëse në veçanti në Siri dhe Irak, dhe kërcënimi ndaj sigurisë që mund të paraqitet kur ata të kthehen, ka të ngjarë të vazhdojë në vitet e ardhshme. Vendet e zgjerimit kanë ndryshuar ligjet e tyre penale dhe legjisllacionin kundër terrorizmit, duke armatosur veten me mjetet më të fuqishme për të luftuar këto fenomene. Disa prej tyre kanë miratuar edhe strategji të reja dhe plane të veprimit anti-terroriste, të cilat kanë lëvizur nga një qasje e pastër e zbatimit të ligjit, e që tani përqëndrohen edhe në parandalim dhe antiradikalizëm. Megjithatë, më shumë duhet bërë për të kundërshtuar radikalizmin në vende, veçanërisht në fushën e arsimit dhe nëpërmjet kontrollit më të mirë të fondeve të huaja që nxisin përmbajtje radikale. BE-ja është duke e

zgjeruar rrjetin e saj të antiradikalizmit (RAN) të vendeve të zgjerimit për të ofruar praktikat e mira të BE-së kundër radikalizmit. Vendet e zgjerimit duhet të vazhdojnë ta përdorin Europol-in si ndërmjetësues për bashkëpunim kundër terrorizmit.

b) Të drejtat themelore

Të drejtat themelore vazhdojnë të jenë të mishëruara në legjislacionin e vendeve të zgjerimit. Në Ballkanin Perëndimor, mangësitë në praktikë ekzistojnë ende, por situata është në përgjithësi e qëndrueshme. Në Turqi, ka pasur ngecje në këtë fushë dhe zbatimi praktik shpesh tregon mangësi të rëndësishme. Pas përpjekjes për grusht shtet në korrik, u shpall gjendje e jashtëzakonshme në kuadër të së cilës janë marrë masa me ndikim të gjerë në kufizimin e të drejtave themelore. Shumë shkelje të rënda mbi ndalimin e torturës dhe keqtrajtimit dhe të drejtave procedurale janë dyshuar si pasojë e përpjekjes së grusht shtetit. Turqia duhet të sigurojë funksionimin efektiv të një sistemi të paanshëm të rishikimit gjyqësor të shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut. Komisioni mirëpret angazhimin e autoriteteve turke për këtë qëllim dhe i kërkon Turqisë të lehtësojë monitorimin e gjykimeve të mëvonshme nga organizatat ndërkombëtare.

Liria e shprehjes dhe medias mbetet një shqetësim i veçantë në shumicën e vendeve të zgjerimit, edhe pse në shkallë të ndryshme. Mungesa e progresit në këtë fushë, tashmë i vërejtur gjatë dy viteve të fundit, ka vazhduar dhe në disa raste është intensifikuar. Situata sa i përket lirisë së shprehjes është përkeqësuar edhe më tej në mënyrë të konsiderueshme në Turqi, në veçanti përmes arrestimeve dhe ndjekjes penale të gazetarëve mbi akuzat për terrorizëm dhe mbylljen e një gamë të gjerë të mediave. Në Ballkanin Perëndimor, ndërhyrja politike në punën e transmetuesit publik, financimit publik jotransparent të medias si dhe frikësimit të gazetarëve ka vazhduar. Për të adresuar këto çështje, duke u bazuar në konferencat Speak Up!, Komisioni do të nisë një koncept të ri të “ditëve të medias” në rajon, duke zgjeruar spektrin e çështjeve që lidhen me median të adresuara përtej lirisë së shprehjes, si e tillë, edhe për të mbuluar funksionimin e tregjeve të mediave, shtrembërimet e konkurrencës dhe çështje të tilla si tregjet financuese dhe reklamuese.

Diskriminimi dhe armiqësia ndaj grupeve në nevojë, përfshirë edhe për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, mbetet një shqetësim serioz. Puna e mëtejshme është e nevojshme për të siguruar barazinë midis burrave dhe grave, duke përfshirë trajtimin e dhunës në familje dhe në baza gjinore, dhe sigurimin e mundësive të barabarta për gratë, veçanërisht në tregun e punës. Të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë edhe zhvillimin e sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe politikave efektive për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara, duhet të forcohen. Situata e vështirë e romëve mbetet gjerësisht e pandryshuar dhe romët, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor, vazhdojnë të jenë viktimat e diskriminimit dhe përjashtimit social. Korniza e politikave për integrimin e romëve ekziston në të gjitha vendet e zgjerimit, por qeveritë duhet të rrisin përpjekjet e tyre për zbatimin e angazhimeve ekzistuese dhe të ndajnë burimet e nevojshme në nivelin qendror dhe lokal.

Mbrojtja efektive e të dhënave personale, si dhe sistemet e fuqishme për të siguruar të drejtat procedurale ende nuk janë themeluar plotësisht në shumë vende të zgjerimit.

c) Migrimi

Kriza e migrimit ka qenë një nga çështjet kyçe në agjendën politike gjatë vitit të kaluar. Ajo vazhdoi të shfaqë rëndësinë strategjike të politikës së zgjerimit në rajon. BE-ja ka reaguar në mënyrë të plotë dhe të ndjeshme ndaj ndjenjave. Mbyllja efektive e rrugës së Ballkanit Perëndimor nga vendet në fjalë, së bashku me Deklaratën BE-Turqi të 18 marsit ka dhënë rezultate të qarta në terren, duke ulur dukshëm numrin e emigrantëve të parregullt dhe

azilkërkuesve të cilët kanë arritur në ishujt grekë, nga disa mijëra në ditë në më pak se 100 në ditë, mesatarisht. Kjo çoi edhe në një rënie të madhe të numrit të jetëve të humbura në det.

Turqia ka vazhduar të bëjë përpjekje të mëdha për të siguruar strehim për më shumë se 2.7 milion refugjatë kryesisht nga Siria dhe Iraku, duke përfshirë zgjerimin e legjislacionit për mbrojtje të përkohshme dhe duke bërë të mundur hyrjen në tregun e punës. Ajo gjithashtu ka forcuar menaxhimin e kufijve dhe ka rritur patrullimin e kufijve tokësor dhe detarë. Objekti i BE-së për Refugjatët në Turqi është duke u hapur me shpejtësi dhe duke dhënë mbështetje konkrete për ata që kanë nevojë. Shuma totale ndarë për objektin aktualisht qëndron në 2.2 miliardë euro, nga të cilat 1,2 miliardë euro janë kontraktuar dhe nga të cilat 677 milionë euro janë ndarë. Serbia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në menaxhimin e flukseve të migrimit. Që nga vera e vitit 2015, këto dy vende më të prekura të Ballkanit Perëndimor, kanë marrë ndihmë humanitare nga BE-ja si dhe ndihmë plotësuese në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit për të mbështetur përpjekjet e tyre pozitive dhe konstruktive për të ndihmuar refugjatët dhe emigrantët në territorin e tyre.

Megjithatë, emigrantët kanë vazhduar përpjekjet e tyre për të arritur destinacionet në Evropë. Disa vende të zgjerimit duhej t'i përshtatnin me shpejtësi kornizat e tyre ligjore dhe institucionale, si dhe infrastrukturën e tyre për të përballuar krizën e migrimit. Kapaciteti administrativ dhe i zbatimit - sidomos kur ka të bëjë me situata të krizës - në të gjitha vendet, kërkon mbështetje të mëtejshme. Veprimet e vazhdueshme kundër kontrabanduesve të emigrantëve nga policia dhe aktorët gjyqësor mbeten të nevojshme, duke përfshirë bashkëpunimin proaktiv dhe shkëmbimin e informacionit me vendet partnere.

Për të reduktuar presionet e migrimit mbi Bashkimin dhe vendet e zgjerimit, instrumente të tjera janë duke u vendosur. Përveç objektit për refugjatët në Turqi, *Fondi i Mirëbesimit Rajonal i BE-së në përgjigje të krizës siriane* dhe marrëveshjet me Jordanin dhe Libanin po ndihmojnë në sigurimin e arsimit dhe punësimit për refugjatët sirianë dhe përmirësimin e mirëqenies dhe të shanseve për jetë të mbetur në rajon. Masa të veçanta mbështetëse dhe ndihma humanitare kanë qenë gjithashtu të vendosur për Ballkanin Perëndimor.

Qytetarët e pesë vendeve të zgjerimit aktualisht përfitojnë nga liberalizimi i vizave për të udhëtuar në BE. Turqia dhe Kosova* kanë bërë përparim të rëndësishëm në përmbushjen e kërkesave të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave në vitin 2016, duke ia mundur Komisionit t'i propozojë Këshillit dhe Parlamentit Evropian, heqjen e kërkesave të vizave edhe për këto shtete, pasi kërkesat e mbetura të jenë plotësuar.

d) Funksionimi i institucioneve demokratike dhe reformave të administratës publike

Funksionimi i duhur i **institucioneve demokratike** mbetet një sfidë kryesore në një numër vendesh. Roli qendror i parlamenteve kombëtare për demokraci duhet të jetë i ngulitur në kulturën politike. Në Turqi, përpjekja për grusht shtet ishte një sulm i drejtpërdrejtë mbi institucionet e zgjedhura në mënyrë demokratike. Duke pasur parasysh seriozitetin e kërcënimit ndaj institucioneve demokratike, një reagim i shpejtë ndaj kërcënimit ishte legjitim.

Megjithatë, shkalla e gjerë dhe natyra kolektive e masave të marra që nga përpjekja për grusht shtet, ka ngritur një numër pyetjesh shumë serioze. Heqja e imunitetit për një numër të madh të anëtarëve të parlamentit në maj është edhe një çështje tjetër për shqetësim.

*Ky emërtim është pa paragjykim për pozicionin mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën e KS- të OKB-së 1244/199 dhe Opinionin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

Në Ballkanin Perëndimor funksionimi i parlamenteve pengohet shpesh nga bojkotet. Edhe pse disa bojkote janë kapërcyer, kultura përçarëse politike mbetet. Marrëveshja e arritur në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë në korrik, e cila implementon Marrëveshjen Pržino të vitit të kaluar, siguron bazën për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në muajin dhjetor 2016. Bojkoti dhe pengimi i veprimtarisë parlamentare nga ana e opozitës ka vazhduar në Kosovë, i cili përfshinte incidente të dhunës. Mbikëqyrja parlamentare është dëmtuar shpesh nga raportimi i pamjaftueshëm i qeverisë, strukturat e dobëta të komisioneve parlamentare dhe përdorimi i tepruar i procedurave urgjente parlamentare. Ndërsa mbajtja e zgjedhjeve ka ndodhur pa incidente të mëdha, mangësi të rëndësishme, duke përfshirë menaxhimin e zgjedhjeve, ndërhyrjet politike në raportimin e mediave kanë ndikim në integritetin e procesit të përgjithshëm parazgjedhor dhe zgjedhor. Zgjedhjet shpesh vazhdojnë të shihen si një mundësi për të fituar kontrollin politik të administratës më të gjerë, duke përfshirë institucionet e pavarura.

Progresi në **reformën e administratës publike** ka qenë i pabarabartë. Në Turqi, ndikimi i numrit të lartë të largimeve të fundit, në profesionalizmin dhe efikasitetin e administratës publike mbetet për t'u vlerësuar. Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë bërë përparim në miratimin e strategjive të reformës së administratës publike dhe programeve reformuese të menaxhimit të financave publike, por zbatimi dhe qëndrueshmëria afatgjatë duhet të sigurohet. Politizimi i shërbimit civil mbetet një çështje shqetësuese. Megjithatë legjislacionin modern të shërbimit civil, përjashtime janë përdorur rregullisht, veçanërisht për emërimet dhe shkarkimet e shërbyesve të lartë civil. Cilësia e hartimit të politikave dhe hartimit ligjor nuk është në përputhje me qasjen e Agjendës së BE-së për rrëgullim më të mirë. Legjislacioni, politikat publike dhe investimet e mëdha janë të përgatitur shpesh pa vlerësime të mjaftueshme të ndikimit dhe konsultime të brendshme dhe publike.

Në shumicën e vendeve, struktura e administratës shtetërore mbetet komplekse dhe nuk ofron llogaridhënie të mjaftueshme. Të drejtat e qytetarëve për administrim të mirë, qasja në informata dhe drejtësi administrative duhet të sigurohet më mirë. Futja e shërbimeve elektronike të qeverisë mbetet prioritet si një faktor kyç për transparencë, shpejtësi dhe qëndrueshmëri në shërbimet publike. Shumë vende kanë bërë progres në miratimin e ligjeve moderne mbi procedurat e përgjithshme administrative, por siguria ligjore mund të sigurohet vetëm atëherë kur procedurat e veçanta administrative kontradiktore janë hequr. Vendet ende kanë nevojë të gjejnë një balanc të përshtatshëm ndërmjet pushtetit qendror, rajonal dhe lokal që më së miri mbështetë zbatimin e reformave dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

e) Ekonomia

Situata ekonomike është përmirësuar gradualisht në Ballkanin Perëndimor, me një rritje të fortë, investime më të mëdha dhe më shumë vende pune të krijuara nga sektori privat. Megjithatë, të gjitha vendet e zgjerimit përballen me sfida të mëdha strukturore ekonomike dhe sociale, me efikasitet të ulët të administratës publike dhe norma të larta të papunësisë. Papunësia e të rinjve në veçanti mbetet ende tepër e lartë. Sistemet e infrastrukturës dhe arsimit duhet të përmirësohen. Përkeqësimi i borxhit publik/raporteve të PPB në rajon është ngadalësuar dhe do të mund të ndalet edhe në disa vende për shkak konsolidimit të mirëpritur fiskal.

Mungesa e mundësive atraktive të punës në vend ka shtyrë shumë njerëz për të migruar. Në të njëjtën kohë, dërgesat e mëdha të remitançave nga jashtë krijojnë pengesa për të kërkuar punësim brenda vendit.

Në kuadër të kornizës së BE-së për të mbështetur qeverisjen ekonomike, të gjitha vendet kandidate dhe kandidatët potenciale janë të ftuar të paraqesin një Programin vjetor të

Reformës Ekonomike (PRE). PRE përmbajnë parashikime afatmesme makroekonomike dhe plane buxhetore për tre vitet e ardhshme, si dhe një listë të masave të reformave prioritare strukturore me qëllim të rritjes së konkurrencës dhe rritjes gjithëpërfshirëse. Procesi i PRE ka ndihmuar në përqendrimin e vëmendjes së qeverive në adresimin e nevojave urgjente për reforma strukturore dhe për të përmirësuar koordinimin. Megjithatë, rezultatet e këtyre përpjekjeve për reforma në jetën e njerëzve ende duhet të materializohen. Ndërgjegjësimi për drejtimin e politikave nga ana e palëve të interesuara dhe përkushtimi për zbatimin e tyre duhet të forcohet.

BE-ja dhe Turqia kanë avancuar përgatitjet e tyre për të negociuar modernizimin dhe zgjerimin e unionit doganor BE-Turqi doganor, i cili ka potencial të madh të pashfrytëzuar. Komisioni është duke punuar në një draft direktivë negociuese që do të prezantohet në fund të vitit 2016.

Klima e investimeve në shumë vende ndikohet negativisht nga dobësitë e vazhdueshme të sundimit të ligjit dhe shenjat e kapjes së shtetit, në veçanti për sa i përket sistemeve të pavarura dhe efikase gjyqësore, zbatimit të pabarabartë të rregullave të konkurrencës, menaxhimit të dobët të financave publike dhe ndryshimeve të shpeshta në lejet dhe taksat, të cilat përkeqësojnë rrezikun e korrupsionit. Kjo është veçanërisht problematike për Ballkanin Perëndimor, duke marrë parasysh mangësitë në kuadër të qeverisjes së korporatave, tregjet e brendshme të vogla dhe të fragmentuara, privatizimit jo të plotë dhe integritetit të kufizuar rajonal të tregtisë. Në Turqi rritja ekonomike është forcuar, por mjedisi i biznesit ka vazhduar të përkeqësohet dhe ekonomia mbetet e brishtë për shkak të pasigurisë financiare, ndryshimeve në besimin e investitorëve globalë dhe rreziqet e vazhdueshme politike. Situata e përkeqësuar e sigurisë ka çuar në një tkurrje të dukshme të sektorit të turizmit.

Duke pasur parasysh ndikimin e sundimit të ligjit në qeverisjen ekonomike, Komisioni do t'i kushtojë vëmendje të veçantë lidhjeve në mes të këtyre dy shtyllave të procesit të anëtarësimit.

f) Bashkëpunimi regional

Shtypsa dhënë nëpërmjet **procesit të Berlinit** dhe Iniciativës për gjashtëshen e Ballkanit Perëndimor, sidomos në lidhje me agjendën lidhëse, ka vazhduar të nxisë rritjen e bashkëpunimit rajonal, stabilizimit politik dhe mundësive ekonomike.

Duke u bazuar në rezultatet e samiteve të mëparshme, samiti në korrik të 2016 në Paris vërejti përparime të mëtijshme në agjendën e lidhjes, duke përfshirë marrëveshjen për të krijuar një treg rajonal për energji elektrike dhe fokusin e shtuar në përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe përdorimin më të madh të energjisë së rinovueshme. Nismat rajonale, të tilla si Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, ka vazhduar të nxisë stabilitet dhe bashkëpunim. Vendet filluan bashkëpunimin në fusha të reja, sidomos nëpërmjet krijimit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) dhe marrëveshje për të nisur një skemë të re pilot, shkëmbimin e nëpunësve civilë të rinj. Vendet e Ballkanit Perëndimor janë pajtuar edhe për masat e lehtësimit të tregtisë dhe liberalizimit të mëtijshëm të tregtisë rajonale. Në fund të fundit, suksesi i bashkëpunimit do të matet kundrejt dorëzimit të projekteve të lidhjes në terren. Tani është urgjente që punimet fizike janë nisur për të siguruar prova të qarta të përfitimeve të drejtpërdrejta për qytetarët. Sa i përket projektve të transportit dhe energjisë, zbatimi i masave të reformave lidhëse për të cilat është rënë dakord në vitin 2015 në samitin WB6 në Vjenë duhet të përshpejtohet.

Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal janë elementet thelbësore të procesit të Stabilizim-Asocimit dhe të zgjerimit. Ka pasur kontakte të vazhdueshme dhe bashkëpunim në nivel bilateral dhe rajonal, edhe në fusha të ndjeshme të tilla si krimet e luftës, personat e zhdukur, kthimi i refugjatëve, krimi i organizuar dhe bashkëpunimi policor. Marrëdhëniet e

mira fqinjësore vazhdojnë të përforcohen përmes iniciativave të ndryshme të bashkëpunimit rajonal. Në të njëjtën kohë, udhëheqja më e përgjegjshme politike dhe përpjekje të mëtejshme drejt pajtimit janë thelbësore për promovimin e stabilitetit dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për të kapërcyer trashëgiminë e së kaluarës. Deklaratat të cilat ndikojnë negativisht në marrëdhëniet e mira fqinjësore duhet të shmangen.

Përpjekjet e mëtejshme janë të nevojshme për të kapërcyer mosmarrëveshjet dypalëshe mes vendeve të zgjerimit dhe me Shtetet Anëtare. Çështjet bilaterale duhet të adresohen nga palët e interesuara sa më shpejt të jetë e mundur dhe nuk duhet të ndalojnë procesin e anëtarësimit, i cili duhet të bazohet në kushtëzimin e themeluar. Rezultatet në këtë drejtim kanë qenë të kufizuara. Progresi në normalizimin e marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës duhet të përshpejtohet. Sa i përket ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ruajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore mbetet thelbësore, duke përfshirë edhe një zgjidhje të negociuar dhe të përbashkët të pranueshme për çështjen e emrit nën patronazhin e OKB. Progresi i bisedimeve të zgjidhjeve, të udhëhequra nga OKB në Qipro është shumë i mirëpritur. Për të lehtësuar progresin e mëtejshëm, Turqia duhet të përmbushë detyrimin e vet për zbatimin e plotë të protokollit shtesë dhe të bëjë progres drejt normalizimit të marrëdhënieve me Republikën e Qipros. Kjo mund t'i japë hov të ri procesit të pranimit. Komisioni gjithashtu kërkon shmangien e çdo lloj kërcënimi apo veprimi që dëmton marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve. Komisioni thekson të gjitha të drejtat sovrane të shteteve anëtare të BE-së. Kjo përfshin ndër të tjera të drejtën për të hyrë në marrëveshje dypalëshe dhe për të eksploruar dhe shfrytëzuar burimet natyrore në përputhje me *acquis* të BE-së dhe të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e OKB-së mbi të Drejtën e Detit.

III. RIKALIBRIMI I PAKOS PËR ZGJERIM

a) Futja e metodologjisë së rikalibruar të raportimit në fushat e reja

Në vitin 2015, Komisioni paraqiti një numër të ndryshimeve të metodologjisë së raportimit. Qëllimi ishte për të rritur më tej mprehtësinë e vlerësimit si dhe përdorshmërinë e pakos si një burim informacioni dhe udhëzimi për të gjitha palët e interesuara dhe për të siguruar transparencë më të madhe në procesin e zgjerimit, duke përcaktuar më qartë se ku qëndrojnë shtetet në përgjithësi. Raportet kanë një fokus të shtuar mbi gjendjen në terren për të treguar më qartë se ku vendet qëndrojnë në përgatitjet e tyre për përmbushjen e kriterëve për anëtarësim, ato ofrojnë udhëzime të forta mbi atë se në çfarë vendet duhet të përqëndrohen gjatë vitit të ardhshëm dhe kanë të përfshira shkallët e raportimit dhe vlerësimit më të harmonizuara, duke u lejuar vendeve që të krahasohen direkt. Këto ndryshime pasqyrojnë më qartë se përpjekjet për integrim evropian të vendeve të zgjerimit duhet të përfshijnë një proces të qëndrueshëm dhe të plotë të reformave politike dhe ekonomike dhe nuk duhet të kuptohet si një grup i ngushtë i negociatave teknike.

Qasja e rikalibruar është zgjeruar më tej në 2016 përtej zonave pilot të mbuluara në 2015¹. Ajo tani mbulon gjithashtu fusha të lidhura me zhvillimin ekonomik (lëvizja e lirë e mallrave, konkurrenca, transporti, energjia), si dhe zona të caktuara të kapitulli 24 (migrimi, kontrolli kufitar, azili dhe lufta kundër terrorizmit) dhe mjedisi dhe ndryshimet klimatike.

¹ Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore (funksionimi i gjyqësorit, korrupsioni, krimi i organizuar, liria e shprehjes), kriteret ekonomike, reforma e administratës publike dhe tre kapituj të lidhura ngushtë me këto themele (prokurimet publike, statistikën, kontrollin financiar).

Ky zgjerim gradual i metodologjisë merr parasysh nevojën për të siguruar sekuencën e duhur të reformave dhe nevojën e vazhdueshme për tu përqëndrohet në baza. Metodologjia e re do të zgjerohet më tej në vitin 2018. Ky zgjerim gradual i metodologjisë merr parasysh nevojën për të siguruar sekuencën e duhur të reformave dhe nevojën e vazhdueshme për tu përqëndruar në baza. Metodologjia e re do të zgjerohet më tej në vitin 2018.

Shkallët e harmonizuara të vlerësimit kanë rritur transparencën dhe krahasueshmërinë e raporteve. Në mënyrë që të kemi rezultate edhe më të sakta, vlerësimi i gjendjes në terren ka qenë shumë i mirë duke përdorur, sipas rastit, hapa të ndërmjetme në mes të çdo dy niveleve ekzistuese.

b) Raportimi i rishikuar mbi kriteret politike

Duke u bazuar në ndryshimet e vitit të kaluar në raportimin mbi kriteret ekonomike, Komisioni ka përpunuar më tej metodologjinë e saj dhe ka rregulluar nënkriteret e që përbëjnë dy kriteret e pranimit ekonomik. Qëllimi i këtij rregullimi është për të siguruar që vendet e zgjerimit do të jetë ekonomisht të afta dhe do të kontribuojnë në konkurrencën dhe stabilitetin e BE-së, kur këto vende të bëhen anëtare.

Nënkriteret e rishikuara nxjerrin në pah të metat kryesore ekonomike të vendeve aktuale të zgjerimit të tilla si mjediset e tyre të dobëta afariste me qasje të kufizuar në financa, normat e larta të papunësisë, rezultatet e dobëta të arsimit dhe niveli i ulët i inovacionit dhe lidhjes rajonale. Ato lejojnë një analizë më të fokusuar të mangësive në funksionimin e tregjeve dhe dobësive në konkurrencë. Fokusi i ri është edhe i përafëruar me PRE dhe në këtë mënyrë kontribuon në ofrimin e udhëzimeve më të qarta për vendet e zgjerimit, në mënyrë të përfutur nga integrimi më i ngushtë me BE-në para anëtarësimit dhe për të përmbushuar kriteret ekonomike.

c) Nga vjeshta në pranverë-kalendari i ri i pakos

Komisioni planifikon të çojë përpara miratimin e pakos vjetore të zgjerimit nga koha tradicionale e vet e fillimit në vjeshtë deri tek një kohë tjetër e fillimit në pranverë. Kjo do të thotë se pakoja e ardhshme nuk do të miratohet në tetor / nëntor 2017, por në pranverën e vitit 2018. Konkluzionet pasuese të Këshillit atëherë do të mund të miratohen në Këshillin e Çështjeve të Përgjithshme (GAC) në qershor. Kjo hapësirë e re kohore do të lejojë Komisionin për të harmonizuar periudhën e raportimit me vitin kalendarik, e cila është baza e zakonshme për mbledhjen e të dhënave statistikore. Kjo ishte propozuar në mënyrë të përsëritur nga vendet e zgjerimit.

Koha e re e pakos do t'a lejojë Komisionin të harmonizojë ciklin e raportimit të pakos me ciklin e PRE. Kjo mund t'i shtojë peshë bazave ekonomike për politika të zgjerimit, të sigurojë koherencë më të fortë në mes të pakos dhe procesit të PRE dhe të punojë që t'i japë dukshmëri më të madhe kësaj të fundit.

IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në analizat e mësipërme dhe vlerësimet e përmbledhjeve të vendeve në shtojcë, Komisioni lëshon këto **përfundime dhe rekomandime**:

I

1. Politikat e zgjerimit të BE-së vazhdojnë të jenë një investim strategjik mbi **paqen, sigurinë, prosperitetin dhe stabilitetin** në Evropë. E ndërtuar mbi kushtëzimin e rreptë por të drejtë dhe mbi parimet e meritave të veta, ajo vazhdon të udhëheqë transformimin dhe modernizimin

në vendet partnere në një mjedis të përgjithshëm të vështirë. Stabilizim nëpërmjet transformimit të tillë është në interes të BE-së.

2. Fokusi i Komisionit në "**bazat e para**", ka dhënë rezultate në terren dhe proceset e reformave janë duke ecur përpara në përgjithësi, edhe pse me shpejtësi të ndryshme. Duke pasur parasysh natyrën komplekse të reformave të nevojshme, ky është një proces afatgjatë dhe mangësitë vazhdojnë të ekzistojnë në një numër fushash të rëndësishme. Reformat janë të nevojshme në fushat e sundimit të ligjit, të të drejtave themelore, institucioneve demokratike dhe reformës së administratës publike si dhe në ekonomi, dhe institucionet e zgjedhura duhet t'i çojnë këto reforma përpara për të mirën e qytetarëve të tyre. Reformat ekonomike dhe forcimi i sundimit të ligjit ofrojnë përfitime të përbashkëta të përforsimit.
3. Bashkëpunimi me Turqinë dhe Ballkanin Perëndimor ka qenë një element i rëndësishëm në trajtimin e **krizës së migracionit** ku disa vende luajtën një rol konstruktiv. BE-ja është duke mbështetur vendet më të prekura, para së gjithash Turqinë, në përpjekjet e tyre për të ndihmuar dhe për të mbrojtur refugjatët dhe emigrantët
4. **Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal** janë pjesë thelbësore e procesit të zgjerimit dhe Stabilizimit Asociimit. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të kapërcyer mosmarrëveshjet dypalëshe, të cilat nuk duhet të pengojnë procesin e pranimit. Bashkëpunimi WB6 në Ballkanin Perëndimor vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në këtë kontekst, duke përfshirë edhe përmes procesit të Berlinit.

Kosova: Komisioni ka mirëpritur hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) më 1 prill 2016, e cila ofron një kornizë gjithëpërfshirëse për marrëdhënie më të ngushta politike dhe ekonomike mes BE-së dhe Kosovës. Kosova ka ndërmarrë hapa të mëdhenj në përmbushjen e kërkesave të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, duke i lejuar Komisionit të nxjerrë një propozim formal në maj të vitit 2016 për heqjen e vizave, me kusht që dy kërkesat e mbetura – ratifikimi i marrëveshjes së kufirit me Malin e Zi dhe vazhdimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit - janë përmbushur. Puna parlamentare është ndikuar negativisht nga pengimi themelor nga parti të ndryshme politike. Aktorët politikë duhet të gjejnë një mënyrë për të kapërcyer bllokimin e zgjatur politik dhe të hapin rrugën për adresimin e sfidave të shumta të reformave të ardhshme, në veçanti për sa i përket sundimit të ligjit dhe nevojës për reforma strukturore ekonomike që trajtojnë nivelin e lartë të papunësisë. Agjenda për Reforma Evropiane është zhvilluar për të ndihmuar zbatimin e nevojshëm të MSA-së. Kosova ka përmbushur detyrimet e mbetura ndërkombëtare në lidhje me themelimin e Dhomave Speciale dhe Prokurorisë Speciale për të hetuar akuzat për krime ndërkombëtare të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë. Mandati i EULEX-it është zgjatur deri në qershor 2018. Kosova ka nevojë për të thelluar angazhimin e saj në dialogun me Serbinë, duke përfshirë zbatimin e të gjitha marrëveshjeve.

Kosova

Sa i përket **kritereve politike**, polarizimi midis qeverisë dhe opozitës ka vazhduar. Funksionimi normal parlamentar është penguar për një pjesë të periudhës së raportimit, duke përfshirë përdorimin e mjeteve të dhunshme nga ana e anëtarëve të opozitës. Të gjitha partitë politike duhet të tregojnë përgjegjësi dhe të riangazhohen në një dialog konstruktiv me parlamentin si forumi kryesor për debat politik. Kthimi i kohëve të fundit i anëtarëve të opozitës në aktivitetet parlamentare, është një hap i mirëpritur.

Institucionet e Kosovës përmbushën detyrimet e mbetura për themelimin e Dhomave Speciale dhe Prokurorisë Speciale për të hetuar akuzat për krime ndërkombëtare të kryera gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. Janë finalizuar procedurat për marrëveshjen dypalëshe me vendin pritës të Dhomave Speciale (Holandën). Mandati i EULEX-it është zgjatur deri në qershor 2018.

Kuvendi ka përfunduar shumicën e emërimeve të institucioneve dhe agjencive të pavarura. Megjithatë, emërimet ishin shpesh objekt i ndikimit politik. Kjo ka dobësuar funksionimin e pavarur dhe menaxhimin efektiv të këtyre organeve. Përpjekje më të mëdha janë të nevojshme për të siguruar se emërimet janë të bazuara në merita.

Ka një nivel të përgatitjes në fushën e reformës së administratës publike. Progresi i mirë ka përfshirë miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të menaxhimit publik financiar dhe të ligjit për procedurat e përgjithshme administrative. Politizimi i vazhdueshëm i administratës publike, megjithatë, mbetet një shqetësim serioz. Organizimi i administratës shtetërore është i fragmentuar dhe nuk siguron linjat efektive të llogaridhënies dhe shkelja e përgjegjësiave të agjencive qeveritare duhet të adresohet. Mbikqyrja parlamentare e aktiviteteve të qeverisë duhet të rritet. Rekomandimet e institucioneve mbikqyrëse duhet të ndiqen për të siguruar një qeverisje dhe llogaridhënie të përmirësuar.

Sistemi gjyqësor i Kosovës është në fazë të hershme. Hapa të rëndësishëm pozitivë janë ndërmarrë gjatë periudhës raportuese me miratimin e amendamenteve të kushtetutës dhe legjislacionit dytësor të nevojshëm për të zbatuar ligjet e pakos së drejtësisë 2015. Kosova ka emëruar edhe shumicën e anëtarëve të institucioneve kryesore dhe ka vazhduar të rrisë normën e zgjidhjes së rasteve. Megjithatë, administrimi i drejtësisë është i ngadalshëm dhe joefikas, dhe nuk ka llogaridhënie të mjaftueshme të zyrtarëve gjyqësorë. Gjyqësori është ende i ndjeshëm ndaj ndikimeve politike dhe institucionet e sundimit të ligjit vuajnë nga mungesa e fondeve dhe burimeve njerëzore.

Kosova është në një fazë të hershme/ka një nivel të përgatitjes në luftën kundër korrupsionit. Kosova ka forcuar kapacitetet e saj institucionale për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, me ngritjen e ekipeve hetimore multidisiplinore, krijimin e një mekanizmi përcjellës për korrupsion e nivelit të lartë dhe rasteve të krimit të organizuar, si dhe ka forcuar departamentin e krimeve të rënda të gjykatave themelore. Kjo ka çuar në rritjen e numrit të rasteve të nivelit të lartë të cilat janë hetuar dhe ndjekur penalisht. Megjithatë, korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem shumë serioz. Një vullnet më i fortë politik për të trajtuar këtë në një mënyrë gjithëpërfshirëse është i nevojshëm.

Kosova është në një fazë të hershme në luftën kundër krimit të organizuar. Numri i hetimeve dhe dënimeve përfundimtare mbetet i ulët. Mangësitë në legjislacion ekzistojnë ende dhe zbatimi duhet të përmirësohet në mënyrë të veçantë mbi shpërlajen e parave, konfiskimin dhe sekuestrimin e aseteve, si dhe hetimin financiar. Ndikimi i tepruar gjatë hetimeve dhe mungesa

e angazhimit strategjik politik pengojnë luftën kundër krimit të organizuar. Kosova ka vazhduar përpjekjet e saj për të luftuar terrorizmin, por ende përballlet me sfida në këtë fushë.

Janë bërë disa përparime në fushën e të drejtave të njeriut, me hapat e ndërmarrë për zbatimin e pakos së ligjeve të të drejtave të njeriut për vitin 2015 dhe përmes deklaratave të përkrahjes për të drejtat e personave LGBTI. Megjithatë, zbatimi vazhdon të pengohet nga mungesa e burimeve dhe angazhimit politik, në veçanti në nivel lokal. Më shumë duhet të bëhet për të garantuar në mënyrë efikase të drejtat pronësore dhe të adresohen çështjet e kthimit dhe riintegritetit të personave të zhvendosur, çështja e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe dhunës me baza gjinore. Mbrojtja e të drejtave të personave që u përkasin minoriteteve dhe personave me aftësi të kufizuara duhet të forcohen në mënyrë të konsiderueshme. Kosova ka një nivel të përgatitjes në fushën e lirisë së shprehjes. Ka pasur zhvillime shqetësuese gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë një numër të kërcënimeve kundër gazetarëve. Asambleja tregon përkushtimin e kufizuar në gjetjen e një zgjidhje për financimin e qëndrueshëm të transmetuesit publik, duke e lënë atë të pambrojtur ndaj presioneve politike. Nuk ka pasur zhvillime legislative për rregullimin e pronësisë së medias dhe transparencës.

Për sa i përket **normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë**, Kosova mbetet e përkushtuar në zbatimin e marrëveshjeve të arritura në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Progresi ka qenë i kufizuar, edhe për shkak të procesit zgjedhor në Serbi dhe gjendjes së brendshme në Kosovë. Megjithatë, vrulli i punës u rikthye në gusht 2016 me fillimin e punës në urën e Mitrovicës dhe lirinë e lëvizjes. Përpjekje të vazhdueshme janë të nevojshme për të zbatuar marrëveshjet e arritura tashmë. Hapat e ndërmarrë duhet të kenë një ndikim pozitiv dhe konkret në jetën e përditshme të qytetarëve në Kosovë dhe Serbi.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Kosova është në një fazë të hershme të zhvillimit të një ekonomie funksionale të tregut. Janë bërë disa përparime, sidomos në mbështetjen e bizneseve të orientuara nga eksporti, përmirësimin e zbatimit të kontratave, veçanërisht në sektorin financiar dhe qasjen në financa. Megjithatë, vendimet fiskale të paqëndrueshme në lidhje me përfitimet e luftës të veteranëve mund të kenë një efekt negativ në stabilitetin makroekonomik të Kosovës dhe marrëdhëniet e saj me institucionet financiare ndërkombëtare. Deficiti i vazhdueshëm tregtar reflekton një bazë të dobët të prodhimit dhe aftësisë konkurruese ndërkombëtare të dobët. Mbështetja në remitancat dhe ekonomia informale e përhapur ulin nxitjen e punësimit, duke rezultuar në pjesëmarrje të ulët të fuqisë punëtore, veçanërisht në mesin e grave dhe shkallë të lartë të papunësisë, veçanërisht në mesin e punëtorëve të rinj dhe të pakualifikuar.

Kosova është në një fazë të hershme të ndërtimit të kapaciteteve për tu përballuar me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit. Nuk ka përparim në përmirësimin e cilësisë së arsimit, i cili është një udhëheqës kyç për përmirësimin e rritjes afatgjatë dhe konkurrencës.

Kosova është në një fazë të hershme të përafrimit me **standardet evropiane**. Përafrimi legjislativ ka vazhduar në disa zona, por zbatimi është i dobët. Është bërë pak progres në fushën e prokurimit publik dhe konkurrencës. Progres i mirë është bërë në fushën e doganave, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit, duke mledhur të ardhurat dhe duke ulur kostot administrative të eksporteve, por Kosova duhet të rrisë luftën kundër ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal. Sektori i energjisë vazhdon të përballlet me probleme, ku asnjë përparim nuk është bërë në mbylljen e termocentralit Kosova A apo renovimin e Kosova B, dhe shumë pak progres bërë në energjinë e rinovueshme.